



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 733/1 Prot.

Tiranë, më 23.05.2022

V E N D I M

Nr. 96, datë 23.05.2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 75 Regj., datë 06.05.2022, të B. P, kundër Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) Epror¹, pranë Shërbimit Social Shtetëror (ShSSH) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në shpjegimet e dhëna nga subjekti ankues, B. P, ajo është shprehur se:

“Vajza ime e mitur X. X³, është me aftësi të kufizuar dhe komisioni mjeko-ligjor që ka caktuar Kemp-in për vajzën time nuk ka përfshirë tek pagesa e përfituar, shpenzimet për paketën higjieno-sanitare, me justifikimin se vajza është në gjendje t’i kryejë vetë nevojat personale, gjë që nuk është e vërtetë. KMCAP Epror e diskriminon vajzën time duke mos i dhënë atë që i takon sipas ligjit, bazuar në aftësinë e saj të kufizuar. Unë nuk kërkoj më shumë se çfarë i takon vajzës time për shkak të gjendjes shëndetësore që ajo ka. Unë e kam kundërshtuar në gjykatë vendimin e KMCAP Epror dhe pretendoj gjithashtu se edhe vendimi e qëndrimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është diskriminues pasi ka mohuar të drejtën ligjore të vajzës time”.

¹ Referuar citimit të parashtrimeve të ankueses.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

³ Në kundërshtim të anonimizimit të të dhënave personale të fëmijës së mitur të ankueses, gjatë vendimit do t’i referohemi me simbolet X. X

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri të konstatohet diskriminimi ndaj vajzës së saj të mitur nga ana e KMCAP Epror dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, konstatohet se:

- Subjekti ankues, B. P është nëna e vajzës X. X, e cila është në moshë minore (15 vjeçe) dhe që nga mosha 3 vjeçare është diagnostikuar me diagnozën “Paraplegji”
- Me Vendimin nr. 173, datë 27.04.2010, të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, Niveli i Parë, Mirditë (KMCAP/Mirditë), X. X. është trajtuar me statusin e “Paraplegjikut” duke përfituar edhe paketën e veçantë higjeno-sanitare.
- Në rikomisionimin e radhës të kryer nga KMCAP Niveli i Parë, X. X., është shqyrtuar për diagnozën “Paraplegjia inferior” në vijim të epikrizës së lëshuar nga mjeku specialist neuro-psikiatër i Poliklinikës së Specialiteteve Mirditë.

- Me Vendimin nr. 877, datë 27.10.2020, të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, Niveli i Parë, për Paraplegji - Tetraplegji dhe Neurologji Tiranë, është vendosur dhënia e të drejtës së përfitimit të statusit të paraplegjikut të X. X, nga data 01.06.2021-01.06.2023, me të drejtë rikomisionimi.
- Duke qenë se vendimi i mësipërm është marrë me divergjencë, pasi kryetari i Komisionit nuk ka qenë dakord, X. X. ka kaluar për shqyrtim pranë KMCAP Epror, me argumentin se vajza në moshën 3 vjeçare është vlerësuar me status paraplegjiku, ndërsa më pas nuk ka patur asnjë ekzaminim të kryer nga QSUT për këtë status, dhe se nuk ka etiologji për status paraplegjiku.
- Me vendimin nr. 414, datë 24.06.2021, KMCAP Epror Paraplegji – Tetraplegji dhe Neurologji, pas kryerjes së vizitës dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimeve përkatëse, ka vendosur që diagnoza e konstatuar është: *“Paraparezë inferiore spastike sinistër, më shumë se dexter propabilisht në terren PCSI, epilepsia e gjeneralizuar”*, dhe se, X. X. nuk përfiton status paraplegjiku por kalon si përfituese e pagesës së aftësisë së kufizuar, grupi i parë me kujdestar.
- Kundër vendimit të KMCAP Epror, ankuesja, B. P ka paraqitur ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë⁴, e cila, nëpërmjet vendimit me nr. 3194, datë 16.11.2021, ka lënë në fuqi vendimin nr. 414, datë 24.06.2021, të KMCAP Epror Paraplegji-Tetraplegji dhe Neurologji Tiranë.

Lidhur me pretendimet e saj përse i takon vendimmarrjes së KMCAP Epror Paraplegji-Tetraplegji dhe Neurologji Tiranë⁵, ankuesja, kundërshtitë dhe mosdakordësinë lidhur me këtë vendim, po e ndjek gjyqësisht, pasi referuar deklarimeve të saj, vendimin nr. 3194, datë 16.11.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e ka apeluar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe aktualisht është në proces shqyrtimi. Pra, është Gjykata Administrative e Apelit Tiranë e cila jep vendimin përfundimtar lidhur me këtë çështje.

Rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtyre organeve, KMCAP Epror apo Gjykatave nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁶.

Në nenin 8 të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 *“Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*, përcaktohet se:

“Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

⁴ Regjistruar pranë kësaj Gjykate, me nr. Regj. Them. 3923, datë 09.09.2021.

⁵ Vendimit nr. 414, datë 24.06.2021, të këtij Komisioni.

⁶ Për analogji citojmë: Vendimin nr.185, datë 28.09.2018, Vendimin nr.55, datë 24.04.2019, Vendimin nr.06, datë 08.01.2020, Vendimin nr. 61, datë 12.06.2020, Vendimin nr. 59, datë 13.04.2021, Vendimin nr. 78, datë 07.05.2021, dhe Vendimin nr. 106, datë 14.06.2021, të KMD, publikuar në ëeb-in e institucionit: ëëë.kmd.al.

- a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha;
- b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;
- c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;
- ç) personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës”.

Neni 29 i këtij Ligji, shprehet në mënyrë të detajuar për procedurën e ankimit, në rastet kur aplikuesit/përfituesit nuk janë dakord me vendimmarrjet e komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se:

“1. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë dhe personi me aftësi të kufizuar, kur gjykon se i është shkelur një e drejtë e garantuar nga ky ligj, mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë bashkisë/njësisë administrative brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

2. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 14 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

4. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Në Kreun IV të Vendimit nr. 182, datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësisë së kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, përcaktohet procedura dhe dokumentacioni për vlerësim dhe përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, në të cilën parashikohet që:

- “Personat, që vlerësohen me aftësi të kufizuar, pajisen nga institucioni i kujdesit shëndetësor, i specializuar me shtretër, me fletën e drejtimit për në KMCAP.

Personat, që rivlerësohen për aftësinë e kufizuar, pajisen nga mjeku specialist me epikrizë, në bazë të rekomandimit të mjekut të familjes. Dokumentacioni për vlerësimin/rivlerësimin e aftësisë së kufizuar, së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit, dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve nga institucioni shëndetësor pranë njësisë administrative ku individi ka vendbanimin.

- *Për personat me aftësi të kufizuar, për të cilët me vendim të komisionit mjekësor është përcaktuar se kanë nevojë për përkujdesje, plotësohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve dokumentacioni për ndihmësin personal, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal.*
- *Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë, paraqesin çdo fillim të vitit ri shkollor/akademik dokumentet e mëposhtme:
a) Vërtetimin, të nënshkruar nga titullari dhe sekretari i institucionit arsimor të mesëm të lartë dhe të lartë, ku të shënohen emri dhe mbiemri i personit, niveli i arsimit që ndjek, viti shkollor/akademik dhe kohëzgjatja. Për të vërtetuar frekuentimin e procesit mësimor vërtetimi lëshohet çdo tre muaj. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të çdo sezoni lëshohet vetëm për personat që ndjekin arsimin e lartë;
b) Kopjen e noterizuar të dëftesës së çdo viti dhe kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së mesme të lartë apo të lartë, si dhe/ose kopje të dëshmisë së kursit të kualifikimit.*
- *Personat me aftësi të kufizuar, të cilët kanë fituar gradë shkencore/titull akademik, paraqesin kopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton fitimin e gradës shkencore/titullit akademik.*
- *Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) në nivel qendror ose rajonal ka të drejtë të verifikojë, me strukturat përgjegjëse për çështjet e arsimit, vlefshmërinë e dokumentit të lëshuar nga ana e institucioneve arsimore.*
- *Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit nga institucioni shëndetësor, e dërgon atë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, me procesverbal, pranë mjekut të drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror, dhe listën emërore të personave që do të vlerësohen apo do të rivlerësohen, pranë KMCAP-së. Mjeku verifikon nëse dosjet e paraqitura janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMCAP. Mjeku mban regjistrin e personave me aftësi të kufizuar, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.*
- *Në rastet e rivlerësimit, administratori shoqëror njofton personin 2 (dy) muaj para përfundimit të afatit të vlerësimit për pajisjen me epikrizën përcjellëse.*
- *Personat, të cilëve u ndryshon gjendja shëndetësore brenda afatit të përfitimit, i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit me fletëdrejtimi të re.*
- *Drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror, në përfundim të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për personat aplikues, hedhin në arkivin elektronik, brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e vlerësimit/rivlerësimit, dokumentacionin që përmban dosja e përfituesit dhe e dërgojnë atë pranë njësisë administrative, të shoqëruar me njoftimin për vendimin për çdo person.*
- *Administratori shoqëror, në bazë të vendimeve të komisionit, përgatit listën e përfituesve të pagesës së aftësisë së kufizuar, të shoqëruar me masën e përfitimit për*

çdo përfitues, përfshirë edhe përfitimet shtesë, të bazuara në dokumentacionin përkatës, sipas legjislacionit në fuqi. Kjo listë i dërgohet çdo muaj strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki për të kryer pagesat.

- *Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki përgatit listën e plotë dhe masat e përfitimit për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar nën juridiksionin e saj dhe mundëson ekzekutimin e pagesave brenda afateve ligjore”.*

Bazuar në sa më sipër, pas marrjes së vendimit të KMCAP Rajonal, nëse personi nuk është dakord me këtë vendim, mund ta apelojë atë në KMCAP Epror të specializuar. Kërkesa bëhet me shkrim nga individit dhe dorëzohet pranë DRSSH në rastin e personave që kanë aplikuar për të përfitur nga skema e invalidëve të punës, ose pranë drejtorive rajonale të SHSSH në rastin e personave që kanë aplikuar për të përfitur nga skema e personave me aftësi të kufizuara. Këto drejtori duhet të dërgojnë kërkesën pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore/ISSH ose SHSSH brenda 10 ditëve. Bashkë me këtë kërkesë, që është ankim nga ana e individit, mjekët e ekspertizës përgatisin dhe një relacion të hollësishëm që argumenton vendimin që kanë marrë.

Aplikuesi ka të drejtën e ankimit për procedurën e vlerësimit edhe në rastet kur ai pretendon për nivelin e përfitimit të pagesës mujore për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në rastet e ankimit të vendimit të KMCAP, Niveli i Parë, për nivelin e përfitimit të aftësisë së kufizuar, Komisioni i nivelit më të lartë në ShSSH, KMCAP Epror, vlerëson nëse ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, dhe vendos përfundimisht me anë të një vendimi i cili në vetvete përbën një akt administrativ.

Përgjigjja e argumentuar, pra vendimi i arsyetuar që marrin këto komisione, lidhet kryesisht me vlerësimin dhe caktimin e diagnozës mjekësore.

Për shkak të natyrës specifike apo natyrës juridike të marrëdhënies që krijohet gjatë vlerësimit të aftësive për punë, këto vendime mund të merren vetëm nga mjekët e specializuar pranë KMCAP-ve Rajonale dhe Epror.

Komisioni i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar është një ekip i përzgjedhur, i përbërë nga mjekë të specializuar, të cilët janë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të aplikuesve për përfitimet në para dhe/ose në natyrë për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar kryesisht në dokumentet e përgatitura nga institucionet shëndetësore.

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 39/1 “Ankimimi në Komisionin Epror”, në pikën të 3 të tij, ka përcaktuar se: “Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë”.

Ligji për Sigurimet Shoqërore deri në vitin 2011 në nenin 35 të tij, e cilësonte vendimin e KMCAP Epror si vendim të paapelueshëm. Paapelueshmëria në këtë rast lidhet vetëm me paapelueshmërinë për ekspertizën, pra, për vendimin mjekësor, për shkak të natyrës së

veçantë juridike. Një vendim i tillë, nuk mund të “goditet” në gjykatë lidhur me vendimin e ekspertizës mjekësore.

Në çështjen Dauti kundër Shqipërisë⁷, GJEDNJ⁸ thekson se: “E drejta për në gjykatë, mbulon çështjet e faktit po aq sa edhe çështjet e ligjit”. Po kështu sipas kësaj gjykate: “...përfitimet e mirëqenies dhe të drejtat e sigurimeve shoqërore janë “të drejta civile” brenda kuptimit të nenit 6/1 të Konventës për të Drejtat e Njeriut⁹, i cili zbatohet në gjykimin në lidhje me to. Kjo çështje ka të bëjë me të drejtën e ankimesit për përfitime mirëqenieje, që është pagesa e paaftësisë që rrjedh nga paaftësia e tij për punë”.

Neni 42 i Kushtetutës vendos standarde kushtetuese si për gjykatat, ashtu dhe për organet e administratës publike. Pika 2 e po këtij neni, sanksionon se kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë, liri apo interes kushtetues e ligjor. Kjo dispozitë, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cënim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar dhe rastin kur cënimi vjen dhe nga një akt administrativ i tillë.

Sipas këtij standardi, individit, në rastin e një vendimi administrativ përfundimtar, ky vendim duhet t’i jepet nga organe administrative që garantojnë cilësitë e një “organi të pavarur dhe të paanshëm”. Prandaj dhe kur ligji përcakton vendimet administrative si vendime të formës së prerë, duhet të garantojë dhe pavarësinë e një organi administrativ njësoj si të ishte “gjykatë” për shqyrtimin e çështjes. Në të kundërt, gjykatat e zakonshme duhet t’i japin akses individit si për çështje ligji dhe për çështje fakti, në mënyrë që atij t’i garantohet e drejta në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në lidhje me pozicionin e KMCAP epror, si organ *quasi* gjykatë, vendimet e të cilit janë të formës së prerë, ligjvënësi pas vendimit Dauti ka bërë rregullime duke ndryshuar rregullat me qëllim përputhjen me kriteret e GJEDNJ për një “organ të pavarur dhe të paanshëm”.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, nr. 113, datë 22.07.2021¹⁰, në të cilin, *inter alia*, citohet se: “... KMCAP Epror nuk rezulton të jetë gjykatë në kuptimin material dhe se nuk mundet të konkludohet se vendimi ka marrë formë të prerë dhe, për rrjedhojë, të mos lejohet ankim në gjykatë. Ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar në vitin 2011, nuk plotëson të gjitha standardet e vendosura nga GJEDNJ, në çështjen “Dauti kundër Shqipërisë” dhe standardet kushtetuese të gjykatës së caktuar me ligj, mbi pavarësinë dhe patundshmërinë e anëtarëve të KMCAP Epror, sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 42, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë, konkludohet se KMCAP Epror, sipas rregullimit që i ka bërë ky ligj, nuk është formësuar si një organ *quasi* gjyqësor. Përderisa nuk plotëson këtë kusht thelbësor, nuk mundet që paditë kundër vendimeve të KMCAP Epror të mos i nënshtrohen kontrollit gjyqësor dhe këto vendime nuk mund të përcaktohen nga ligji si akte administrative të pakundërshtueshme.

⁷ Vendim i datës 3 Shkurt 2009.

⁸ Shkurtesë për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

⁹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën: KEDNJ

¹⁰ M. Sh kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Neni 39/1, pika 3 i ligjit nr. 7703/1993, në pjesën ku parashikon se "...Vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë", vjen në kundërshtim me Vendimin e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut në çështjen "Dauti kundër Shqipërisë". Si rrjedhojë, kjo dispozitë mbetet e pazbatueshme, për aq sa rregullimi ligjor për KMCAP nuk arrin të plotësojë kushtet e një organi quazi gjyqësor. Në rastet ku kundërshtohet një vendim i KMCAP Epror, sipas këtij ligji, do të zbatohet drejtpërdrejtë ky vendim i GJEDNJ-së, dhe dispozitat kushtetuese dhe ligjore të përgjithshme që garantojnë kontrollin gjyqësor mbi aktin administrativ".

Bazuar në sa më sipër, ankuesja duke mos qenë dakord me vendimin e KMCAP Epror, i cili është i formës së prerë por jo përfundimtar, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për ta kundërshtuar gjyqësisht atë.

Në ankesën e bërë pranë KMD-së, ankuesja ka kërkuar që diagnoza e vajzës së saj, të ndryshohet nga ajo që ka përcaktuar KMCAP Epror.

Lidhur me këtë kërkim të ankuses, Komisioneri çmon se ky vlerësim mund bëhet vetëm nga komisionet e specializuara për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara. Për më tepër, ankuesja, vendimin në fjalë e ka kundërshtuar edhe gjyqësisht dhe ai është objekt i shqyrtimit gjyqësor aktualisht.

Subjekti ankues, ka ngritur pretendime edhe ndaj sistemit të drejtësisë, dhe konkretisht kundrejt vendimmarrjes së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Lidhur me kërkesën e paraqitur nga ankuesja, që KMD, të konstatojë diskriminim të vajzës së saj, lidhur me vendimmarrjen e gabuar, në dëm të interesit të fëmijës, nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Komisioneri, vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për rrjedhojë, Komisioneri nuk mund të vlerësojë vendimmarrjen e gjykatës sipërcituar.

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *"Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës".*

Në vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, të Gjykatës Kushtetuese¹¹, ndër të tjera, thuhet se: *"Në ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", është përcaktuar se: "...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta". Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet në mënyrë të shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, nuk ka të drejtë të kontrollojë e vlerësojë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi*

¹¹ "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, në nenin 132, të saj, ka përcaktuar se: *"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim".*

gjqqtarin e çështjes. Duke iu referuar praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se, asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”.

Neni 135, pika 1 e Kushtetutës, bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve dhe në të njëjtën kohë kërkon t’i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe ia nënshtrohet veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në kodet e procedurave.

Në nenin 145, të Kushtetutës, sanksionohet se, gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke nënkuptuar kështu, pavarësinë, përgjegjësinë dhe kompetencat e veçanta të gjyqtarit në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet vendimmarrjes së çështjes konkrete. Asnjë pushtet apo organ tjetër nuk mund të veprojë si gjykatë dhe të marrë kompetencat e saj.

Komisioneri vlerëson se, nëse subjekti ankues nuk është dakord dhe ka pretendime lidhur me vendimmarrjet e cilësdo gjykatë, duhet t’i drejtohet gjykatës më të lartë, sikurse në rastin konkret ka vepruar pasi e ka apeluar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa, lidhur me pretendimet për anësi apo pretendime të natyrës profesionale apo etike mund t’i drejtohet Këshillit të Lartë të Gjyqësor¹² apo Inspektorit të Lartë të Drejtësisë¹³, të cilët janë organet kompetente të caktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për shqyrtimin e tyre.

Pretendimet e subjektit ankues mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimimit përpara gjykatave të shkallëve më të larta. Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit dhe për sa kohë nuk janë prishur apo ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjykatën apo gjyqtarin e çështjes që e ka shqyrtuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim dhe kontrolli i vendimeve të gjykatave, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj¹⁴.

¹² Neni 147/a, i Kushtetutës, përcakton ndër të tjera, se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;
b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve”.

¹³ Neni 147/d, i Kushtetutës, përcakton ndër të tjera, se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”.

¹⁴ Për analogji citojmë Vendimin nr. 02, datë 11.01.2021, të KMD-së.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankueses për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues B. P, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Hartoi: R. Hoxha
Rishikoi: R. Babaj
Miratoi: V. Bushati
Datë: 18.05.2022